

LUDMILA BUXHELI

CAMAJ GRAMATIKAN - RASTI I FOLJEVE PAVETORE TË SHQIPES

(Vështrim përqasës)

Foljet pavetore janë vlerësuar nga ndonjë gjuhëtar i huaj si “l’enfant pauvre” i gramatikës¹. Arsyeja është se, ndryshe nga grupet e tjera foljore, ato përfaqësojnë një kategori fjalësh, të vogël nga pikëpamja sasiore, që ndonjëherë nëpër gramatika ose nuk përmenden fare, ose për to flitet shumë pak. Ky pohim duket se vlen pjesërisht edhe për gramatologjinë shqiptare. Kështu, ndonëse mjaft rrallë, në ndonjë gramatikë, ato ose nuk përshkruhen fare (A. Dozoni²) ose përmenden, por pa asnjë shpjegim për to (Pekmezi³). Megjithatë, për foljet pavetore të shqipes nuk mund të thuhet se “janë aq pa fat”, sepse në shumicën e gramatikave ato studiohen si grup më vete, ndonëse mbi bazën e kriterëve, shpeshherë të ndryshme dhe me shpjegime sintetike, që në më të shumtën e rasteve nuk janë më shumë se një gjysmë faqeje. Për pasojë, i njëjti term jo gjithmonë emërton të njëjtin grup foljesh dhe i njëjti term jo gjithmonë interpretohet në të njëjtën mënyrë.

Gramatika e Camajt⁴ bën pjesë në grupin e gramatikave që u kushtojnë vend të veçantë foljeve pavetore. Por jo vetëm kaq. Gramatika e Camajt, krahas gramatikës së N. Resulit⁵, është ndër të paktat gramatika, në të cilat foljet pavetore të shqipes, ndonëse në mënyrë të përmbledhur, përshkruhen jo më brenda një a dy paragrafesh, por në një shtrirje prej disa faqesh⁶.

¹ B. Bauer, *Archaic Syntax in Indo-European: The Spread of Transitivity in Latin and French*, Mouton de Gruyter, Berlin-New York, 2000, f. 93.

² A. Dozon, *Manuel de la langue chkiye ou albanese*, Paris, 1879.

³ Gj. Pekmezi, *Albanesisshen Sprache*, (1908), Wien.

⁴ M. Camaj, *Albanian Grammar*, with Exercises, Chrestomachy and Glossaries, Collaborated on and translated by Leonard Fox, Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1984.

⁵ N. Resuli, *Grammatica albanese*, Bologna, 1985, f.548-552.

⁶ M. Camaj, *Albanian Grammar*, with Exercises, Chrestomachy and Glossaries, Collaborated on and translated by Leonard Fox, Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1984, f. 199-202.

Kështu që është me mjaft interes njohja me konceptin e Camajt për foljet pavetore të shqipes, përjashtuar edhe me mënyrën e interpretimit të këtyre foljeve në gramatikat e tjera të shqipes. Në këtë mënyrë jo vetëm hidhet dritë në mendimin gjuhësor të Camajt për foljet pavetore, por njëkohësisht identifikohen problemet që lidhen me këtë kategori fjalësh, që asnjëherë nuk ka qenë objekt i ndonjë studimi të veçantë për shqipen.

Në konceptin e Camajt, foljet e shqipes, sipas paradigmës vetore, ndahen në dy grupe: a) folje që zgjedhohen në të tri vetat dhe b) folje që zgjedhohen vetëm në vetën e tretë. Mendimi gjuhësor i Camajt, përputhet me atë të pjesës dërmuese të autorëve të gramatikave të shqipes, të cilët gjithashtu sipas kundërvënies së paradigmës vetore, kanë parapëlqyer vetëm ndarjen në dy grupe: a) në folje që zgjedhohen në të gjitha vetat; b) në folje që zgjedhohen vetëm në vetën e tretë. Përfundimisht bën vetëm Gramatika akademike (2002), në të cilën foljet ndahen në tri grupe: *vetore-njëvetore-pavetore*.

Duke u njohur me këto gramatika, spikatin dy probleme kryesore të cilat janë: a) mungesa e një terminologjie të njësuar, b) mbi të gjitha zbatimi i kriterëve të ndryshme për përshkrimin e këtyre grupeve foljore.

Mungesa e një terminologjie të njësuar ndodh për shkak të kriterëve jo të njëjta që zbatohen gramatikanët për dallimin e këtyre foljeve. Nëse do ta vështronim në planin fjalëformues, nëpër gramatikat e shqipes, e më rrallë në ndonjë gramatikë të huaj të përkthyer në shqip, termi i përdorur për emërtimin e foljeve të tipit *erret* është një mbiemër i prejardhur me parashtesë, përkatësisht parashtesa *pa-* e më rrallë me parashtesën *z-*⁷, i krijuar sipas të njëjtit model fjalëformues të përdorur nëpër gramatikat bashkëkohore të gjuhëve latine e gjermanike për këtë term (*impersonel* etj.). Më rrallë, në gramatikat e shqipes, ndryshe nga këto gjuhë, parapëlqehet mbiemri i përbërë (*njëvetore*). Në të dy rastet mbiemrat ndërtohen mbi bazën e fjalës *vetë* si temë fjalëformuese, e cila kuptimisht i referohet termit gramatikor *vetë*, ndonëse shpjegimi mund të bëhet edhe me mjete jo formale.

Megjithatë, pjesa më e madhe e studiuesve parapëlqejnë termin *pavetore*. Një pjesë më e vogël syresh përdorin termin *njëvetore*. Nuk përjashtohen edhe rastet e përdorimit njëherësh dhe pa asnjë dallim kuptimor të të dy termave, *njëvetore* dhe *pavetore*.

Camaj parapëlqen termin *pavetore* për emërtimin e foljeve që zgjedhohen vetëm në vetën e tretë. Në këtë mënyrë ai renditet krahas I. D.

⁷ *Gramatika Latine* (Tubë librash për shkollë gymnazike e tregtare botue prej etnve jezuit. Bleni I, Shkodër 1921, f. 7.

Sheperit⁸, J. Rrotës⁹, K. Cipos¹⁰, O. Myderrizit¹¹, Resulit¹², etj. të cilët gjithashtu foljet i grupojnë vetëm në dy grupe, *vetore* dhe *pavetore*, por ai dallohet nga K. Kristoforidhi, A. Xhuvani, të cilët termat *pavetore* dhe *njëvetore* i përdorin pa ndonjë dallim ndërmjet tyre, për të emërtuar gjithë foljet që u kundërvihen foljeve trivetore. Në përzgjedhjen e termit Camaj dallohet edhe nga Riza e Demiraj, të cilët përdorin termin *njëvetore* në vend të termit *pavetore*.

Ashtu si për përzgjedhjen e termit, edhe shpjegimi i këtij termi nuk bëhet në të njëjtën mënyrë, sepse kriteret janë të ndryshme. Herë merret si bazë paradigma e foljes sipas vetës¹³, herë kryefjala¹⁴, herë kuptimi leksikor¹⁵. Jo gjithmonë studiuesit i zbatojnë të gjitha këto kritere njëherësh. Për dallimin e këtyre foljeve edhe Camaj është mbështetur në tri kritere, të cilat shoqërohen me shpjegimet përkatëse, por ai i emërton disi ndryshe: 1) struktura formale, 2) përmbajtja, 3) diateza. Për pasojë edhe shpjegimi i termit *pavetore* bëhet sipas këtyre kritereve.

Kur flet për strukturën formale Camaj ka parasysh dy veçori: a) veçoritë *morfologjike*, përkatësisht formën *vetore*, dhe b) veçoritë *sintaksore*, përkatësisht kryefjalën. Sipas këtyre kritereve Camaj dallon disa grupe foljesh *pavetore*, të cilat i përshkruan në këtë mënyrë:

a) folje që dalin gjithmonë në vetën e tretë, ose me kryefjalë të shprehur: (*bie shi*), *zë qelb* ose me kryefjalë të nënkuptuar: *gjëmon (moti)*, *pëllet (lopa)*.

b) folje që dalin gjithmonë në vetën e tretë, por pa kryefjalë: *erret*, *ndodh*, *ngjan*, *duhet*, *përflitet*, etj.

c) folje, të cilat ndonëse janë në vetën e tretë, kanë lidhje të ngushtë me me kategorinë e numrit nëpërmjet përemrit vetor në dhanore, i cili sipas tij funksionon si një subjekt logjik. Foljet e këtij grupi emërtohen nga autori edhe me termin *pavetore të figurshme (figurativ impersonal)*.

⁸ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, f. 159.

⁹ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Shkodër, 2006, f. 327.

¹⁰ K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë, 1952.

¹¹ O. Myderrizi, *Gramatika e Re e shqipes*, Vëllimi I, Fonologji e morfologji, 1944, f. 250.

¹² N. Resuli, *Grammatica albanese*, Bologna, 1985, f. 548-552.

¹³ K. Kristoforidhi, *Gramatiki tis alvanikis glossis*, Kostantinopojë, 1872, f. 150-151.

¹⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.

¹⁵ N. Resuli, *Grammatica albanese*, Bologna, 1985, f. 548-552.

Te Camaj kriteri strukturor zbatohet si një kombinim i veçorive morfologjike, përkatësisht i formës foljore të vetës së tretë, me ato sintaksore, distribucioni i kryefjalës. Për pasojë, gramatika e Camajt ka më shumë ngjashmëri me shumicën e gramatikave të tjera të shqipes, si p.sh. ajo akademike, por edhe më herët me gramatikën e I.D.Sheperit, J. Rrotës, K. Cipos, O. Myderrizit, Demirajt dhe në veprën e Rizës.

Megjithatë, nuk ka përputhje të plotë në mënyrën e zbatimit të kriterit formal si një kombinim i formës gramatikore të foljes me rolin e kryefjalës, sepse nëpër gramatika herë i jepet përparësi formës vetore, herë i jepet përparësi rolit të kryefjalës. Në gramatikën e Camajt forma e vetës së tretë, si e vetmja formë foljore që nuk hyn në lidhje paradigmatisht me forma të tjera vetore, vlerësohet si tipari strukturor kryesor për dallimin e foljeve pavetore. Karakterizimi i foljeve pavetore së pari sipas formës gramatikore ndeshet edhe në pjesën më të madhe të gramatikave. Por, në këto raste, Camaj nuk vë kufizime lidhur me kuptimet e kësaj forme foljore. Shembujt e dhënë prej tij tregojnë se forma foljore e vetës së tretë të foljeve pavetore, ndryshe nga përcaktimi i gramatikës akademike ose edhe i shpjegimit që jepet në Fjalorin e 1980 për këto folje, mund të karakterizohet kuptimisht *edhe* si një formë me kuptimin e saj parësor, d.m.th. si formë që i referohet një vete të caktuar, *por edhe* si një formë me një kuptim të veçantë, që nuk i referohet një vete të caktuar. Kështu që, për Camajn ndërtime me folje pavetore janë edhe *blegërin delja*, edhe *erret*, edhe *më flihet*.

Mendimi gjuhësor i Camajt për kuptimin e formës gramatikore të vetës së tretë si mjet formal i dallimit të foljeve pavetore ka ndikuar edhe në përcaktimin e rolit të kryefjalës, gjithashtu si mjet strukturor-formal i dallimit të këtyre foljeve. Camaj nuk e shikon mungesën e kryefjalës si një tipar strukturor gjithëpërfshirës për gjithë foljet pavetore, kështu që për nga rëndësia, ai e rendit këtë nënkriter të dytin, pas nënkriterit të formës gramatikore. Për pasojë, ndryshe nga Sheperi, J.Rrota, Myderrizi, Demiraj, Cipo, Resuli, Gramatika akademike etj., por njësoj si Leotti¹⁶, Lacalendola¹⁷, në mënyrë shumë të qartë Camaj e zgjeron rrethin e foljeve pavetore, sepse përfshin brenda këtij emërtimi si foljet me kryefjalë (*blegërin delja*, *bie shi*), ashtu edhe ato që përcaktohen prej tij si *folje pa kryefjalë*, të cilat duket se janë të pakta në gjuhën shqipe, sepse ai liston folje si *erret*, *ndodh*. Pjesa më e madhe e foljeve pavetore listohen prej tij

¹⁶ A. Leotti, *Grammatica elementare della lingua albanese* (dialetto toscano). Heidelberg, 1915.

¹⁷ A. Lacalendola, *Grammatica della lingua albanese*, 1930.

si folje me kryefjalë. Kjo është arsyeja që foljet pavetore, të cilat emërtojnë veprime të kryera nga sende dhe kafshë, në këtë gramatikë numerikisht përbëjnë shumicën. Duke e vendosur nënkriterin e kryefjalës të dytin, pas atij të paradigmes vetore, Camaj renditet krahas Demirajt, Gramatikës akademike, por dallohet p.sh. nga J. Rrota, i cili shpjegimin për foljet pavetore e nis nga kriteri i kryefjalës, kurse formën e foljes e rendit të dytën si kriter dallues. Rrota pohon se “verbi përkahë subjekti mund të jetë *vetuer* a *pavetuer*. Të parët (*vetorët*) janë ata që mund të lidhen me gjithë përemnat *vetorë*; të dytët, (*pavetorët*) janë ata verba, të cilët nuk përdoren, veç në vetën e tretë njëjës, pa e shprehë gjithmonë të qartë subjektin”¹⁸. Për pasojë, grupi i foljeve pavetore, sipas Rrotës, është më i vogël nga pikëpamja sasiore, sesa ai i foljeve të listuara nga Camaj.

Camaj dallohet edhe nga Resuli, i cili shpjegimin e termit “folje pavetore” e bën së pari sipas kuptimit leksikor e më pas vijon me rolin e kryefjalës¹⁹.

Siç shihet, nuk ka një mendim unik për kriteret në përgjithësi dhe për rolin e kryefjalës në veçanti. Më herët, në pjesën e sintaksës, edhe Sheperi nuk është gjithmonë i prerë për praninë ose mungesën e kryefjalës, kur pohon se foljet pavetore “e marrin vetën si plotës në rasën dhanore (plotës *vetor*) dhe për kryefjalë ose kanë një fjali të dytë ose u nënkuptohet ndonjë emër kuptimi, i prejardhur nga rrënjë të tyre. P. Sh. *Më ngjan* që erdhi. Nuk *më flihet*”²⁰, *më shkruhet* (shkrimi), *më flihet* (flejta), *vetëtin* (vetëtim), *gjëmon* (gjëmimi) etj.²¹, *Duket që do të bjerë shi. Më ngjan se erdhi*”²².

Kurse te Riza nuk bëhet fjalë drejtpërdrejt për rolin e kryefjalës si tipar dallues strukturor. Riza vëren se “ky dallim gjuhësor i foljeve në trivehtjore dhe njëvehtjore pasqyron ndryshimin brendior të fenomeneve përkatës”²³. Sipas tij, kriter kryesor për dallimin e foljeve njëvetore të tipit *erret* është brendia e këtyre foljeve, e cila shfaqet në atë që këto folje shprehin veprime me bartës të panjohshëm e për pasojë të përealizueshëm fonetikisht. Sipas Rizës, forma e vetës së tretë në foljet njëvetore të tipit *erret* është pasojë e kuptimit të këtyre foljeve

¹⁸ At J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Shkodër, 2006, f. 327

¹⁹ N. Resuli, *Grammatica albanese*, Bologna, 1985, f. 548.

²⁰ K. Cipo, *Sintaksa*, 1952, f. 159.

²¹ I. D. Sheperi, *po aty*, f. 159.

²² I. D. Sheperi, *po aty*, f. 159.

²³ S. Riza, *po aty*, f. 110.

Nga ky vështrim përqasës i trajtimit të foljeve pavetore në gramatikën e Camajt me disa nga gramatikat e tjera të shqipes vërejmë se foljet pavetore ngërthejnë në vetvete shumë probleme, sqarimi i të cilave nuk ka qenë gjë e lehtë. Një pjesë e mirë e këtyre problemeve pasqyrohen edhe në gramatikën e Camajt. Këto probleme kanë të bëjnë me disa dukuri, si p.sh:

- a) ndarja e foljeve sipas paradigmes vetore në dy apo tre grupe.
- b) përzgjedhja e termit (*pavetore* ose *njëvetore*) si dukuria e parë, që bie në sy për emërtimin e tyre, ndonëse jo më e rëndësishmja; duket qartë që ka një konfuzion terminologjik.
- b) shpjegimi i termit të përzgjedhur (*pavetore* ose *njëvetore*);
- b) roli i kryefjalës si i domosdoshëm ose jo i domosdoshëm në karakterizimin e foljeve që përdoren vetëm në vetën e tretë;
- c) por mbi të gjitha përcaktimi i kriterëve për dallimin e foljeve pavetore nga foljet e tjera që përdoren në vetën e tretë, që do të thotë nëse këto folje do të përshkruhen sipas formës gramatikore, sipas rolit të kryefjalës, sipas kuptimit leksikor etj.

Ne pajtohemi me mendimin e Camajt, i cili është mbizotërues në shumicën e gramatikave, që foljet e shqipes, sipas kundërvënies paradigmatiske vetore, duhen ndarë në dy grupe kryesore, a) në folje që zgjedhohen në të tria vetat, b) në folje që zgjedhohen vetëm në vetën e tretë dhe jo në tri: a) në folje që zgjedhohen në të tria vetat, b) në folje që zgjedhohen vetëm në vetën e tretë dhe c) në folje pavetore. Duke u nisur nga parimi që një rregullë gramatikore duhet të jetë sa më e thjeshtë, pa përjashtime ose kombinime me rregulla a kriterë të tjera, ndarja binare e foljeve sipas kundërvënies paradigmatiske të vetës i përmbush këto kërkesa, sepse në këtë ndarje zbatohet vetëm një kriter, ai i formës, kurse në ndarjen në tre grupe *vetore* / *njëvetore* / *pavetore* duket qartë që nuk zbatohet vetëm një kriter, sepse foljet *njëvetore* mund të grupohen fare lehtë me si foljet trivetore ashtu edhe me foljet pavetore. Nëse, p.sh. do të merrej për bazë kriteri i kryefjalës, nuk ka si për ligjet veçimi i foljeve njëvetore të tipit *cicëron zogu* nga foljet e tipit *lexoj*, sepse ato kanë si tipar të përbashkët praninë e kryefjalës. Krahason p.sh.: *cicëron zogu*, *Vera lexon* ku kryefjala, edhe nëse mngon, është e nënkuptueshme, pra s'ka pse të veçohen si grup më vete, përkundrajt foljeve *u err*, *u gdhi*, kryefjala e të cilave nuk nënkuptohet. Normalisht, sipas kriterit të kryefjalës grupimi i këtyre foljeve përsëri do të duhej të ishte binar. Kurse nëse do të merrej si bazë kriteri formal, përsëri foljet e quajtura njëvetore nuk ka arsye të dalin grup më vete, i dallueshëm nga foljet e tipit *erret*.

Po ashtu, ne pajtohemi edhe me mendimin tjetër të Camajt, që e ndeshim më herët te Demiraj e Riza, se në këtë grupim binar foljet e

përdorura vetëm në vetën e tretë njëjës nuk formojnë një grup homogjen, por ndahen më tej në nëngrupe, ndryshe p.sh. nga Cipo, i cili në grupin e foljeve që përdoren vetëm në vetën e tretë përfshin vetëm folje të tipit *erret, ndodh*²⁴. Kjo do të thotë që përshkrimi i këtyre foljeve vetëm sipas formës nuk është i mjaftueshëm.

Megjithatë, nisur nga ndarja formale në dy grupe, mbështetur në karakteristikat e foljeve të tipit *blegërin, vetëtin, më teket* etj. mendojmë se dy janë kriteret kryesore për dallimin e këtyre foljeve: a) forma gramatikore morfologjike dhe b) kuptimi, me të cilin kemi parasysh strukturën argumentore ose valentore të këtyre foljeve. Mbi bazën e këtyre dy kriterëve duhet bërë edhe përzgjedhja e termit për emërtimin e tyre.

Konkretisht, analiza e foljeve të tipit *erret, më teket* mendojmë se duhet filluar nga forma gramatikore, veta e tretë njëjës, ndonëse ky kriter nuk është kryesori. Duke dalluar nga njëra anë foljet që zgjedhohen në të gjitha vetat prej foljeve që zgjedhohen vetëm në vetën e tretë, te foljet e tipit *erret, më teket* forma e vetës së tretë njëjës është tipari gramatikor që i bashkon këto folje. Parë në këtë këndvështrim këto folje morfologjikisht përbëjnë një grup homogjen me ato të tipit *blegërin (delja)*, me tipar të përbashkët formën e vetës së tretë njëjës, e cila nuk hyn në kundërvënien paradigmatisht me dy format e tjera. Kështu që nuk ka arsye të veçohen nga foljet e tipit *blegërin*. Për pasojë, edhe termi *njëvetore* na duket më i pranueshëm. Nëpërmjet tij vihet në dukje një tipar gramatikor gjithmonë i pranishëm, që karakterizon foljet e tipit *erret, më teket*: forma vetore e pranishme.

Megjithatë, forma e vetës së tretë nuk është kriter i vetëmjaftueshëm për dallimin e këtyre foljeve, sepse, sipas përmbajtjes, foljet që zgjedhohen vetëm në vetën e tretë nuk janë homogjene. Kjo është arsyeja që në traditën gramatikore të shqipes në këto raste përdoren edhe kriterë të tjera dalluese, si p.sh. ai i kryefjalës, i kuptimit leksikor e, më rrallë, ai i bartësit të panjohshëm të veprimit (Riza) ose i kuptimit të veçantë të formës së vetës së tretë (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980).

Për sa i përket mungesës së kryefjalës si kriter strukturor për dallimin e foljeve të tipit *erret, më teket*, mendojmë se nuk është i vetëmjaftueshëm, ai ka nevojë të saktësohet më tej. Arsyeja është se jo gjithmonë pamundësia e përdorimit të kryefjalës nënkupton praninë e një foljeje pavetore. Në gjuhën shqipe ka mjaft struktura, në të cilat kryefjala nuk mund të shprehet fonetakisht e megjithatë folja është vetore. Kemi parasysh jo vetëm strukturat me format foljore të pashtjelluara (*shkoi ø për*

²⁴ K. Cipo, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1949, f. 151.

të marrë biletën), por edhe struktura me forma foljore të shtjelluara me folje në lidhore që u përkasin fjalive të varura jolidhëzore të tipit “*përpiqem ø të punoj mirë*”, “*shkoj ø të marr biletën e avionit*”, “*I thashë Agimit ø të vijë në kohë*”²⁵.

Edhe shpjegimi i Rizës për foljet e tipit *erret* si folje njëvetore me bartës të panjohshëm veprimi, përkundrejt foljeve të tipit *blegërin*, si folje me bartës të njohshëm, ndonëse është më afër thelbit të këtyre foljeve, ka nevojë të saktësohet më tej, sepse p.sh. për folje të tipit *më teket*, të cilat renditen krahas foljeve të tipit *erret*, nuk mund të mohohet prania e bartësit ose e përjetuesit të veprimit.

Po ashtu, edhe përcaktimi i fojeve pavetore si folje që tregojnë dukuri atmosferike nuk është i vetëmjaftueshëm, sepse shumë prej tyre kanë kuptime të tjera leksikore.

Ne mendojmë se kriteri i dytë, por jo më pak i rëndësishëm, është *ai i strukturës argumentore* ose *valentore të foljes* dhe roleve semantike që caktojnë këto folje. Mungesa e kryefjalës në fjali me folje të tipit *erret*, *më teket* etj. dhe prania e saj në fjali me folje të tipit *blegërin delja* mund të shpjegohen vetëm me karakteristikat e strukturës valentore dhe semantike të foljeve, e cila projektohet në fjali nëpërmjet sintagmave dhe përcakton strukturën sintaksore të fjalisë (L.Haegeman²⁶, R. Memushaj)²⁷. Në gjuhën shqipe foljet e tipit *erret*, *më teket*, ndryshe nga foljet e tipit *blegërin*, mund të përshkruhen si folje njëvetore që nuk mund të kenë valencë/argument të jashtëm as të shprehur fonetikisht me një SE, as të nënkuptueshëm, sepse këto folje nuk mund të caktojnë asnjë rol semantik të jashtëm, e për pasojë asnjë argument të jashtëm. Karakteristikat e strukturës valentore të foljeve të tipit *erret* projektohen edhe në strukturën sintaksore të fjalisë nëpërmjet mungesës së kryefjalës si një përfaqësuese e argumentit të jashtëm, që do të mbartte një rol semantik të caktuar.

Mbështetur në strukturën argumentore e semantike të foljeve, edhe mungesa e kryefjalës në fjali me folje në lidhore/ paskajore të tipit *shkoj të punoj* ose *shkoj me punu* përkundrejt mungesës së kryefjalës në rasën emërore në fjali me folje të tipit *erret*, nuk ka të njëjtin shpjegim. Ndërsa në fjali me folje të tipit *erret*, mungesa e kryefjalës shpjegohet me

²⁵ Shënim: Simboli ø përfaqëson një sintagmë emërore të pashprehur, në funksionin e kryefjalës. (LB).

²⁶ L. Haegeman, *Introduction to government and binding theory*, nd edition, Reprinted, Blackwell, Cambridge, MA, 1992.

²⁷ R. Memushaj (2009), *Bukuria e gjuhës. Gjuha shqipe 2, për klasën e dytë të gjimnazit të përgjithshëm*, Podgoricë.

karakteristikat e strukturës valentore e semantike të foljeve të tipit *erret*, në fjali të tipit *shkoj* *o* të *punoj* mungesa para foljes në lidhore të kryefjalës së shprehur me SE nuk është pasojë e strukturës valentore, por e mënyrës së caktimit të rasës emërore për këtë SE.

Si përfundim, midis shumë çështjeve gramatikore të karakterit morfologjik e sintaksor të shqipes së sotme, që kanë tërhequr vëmendjen e Camajt në Gramatikën e tij, në këtë kumtesë ne u përqendruam te koncepti i Camajt për foljet pavetore, ndonëse edhe çështje të tjera gramatikore që lidhen me sistemin foljor e më gjerë, të përshkruara në këtë gramatikë, janë me po aq interes e meritojnë vëmendje. Duke u njohur me mendimin gjuhësor të Camajt për foljet e tipit *erret*, *më teket*, përjasur edhe me gramatikat e tjera të shqipes, kemi bindjen se kjo klasë fjalësh është mjaft problematike, sidomos për sa i përket përcaktimit të kriterëve dalluese dhe emërimit, të cilat mendojmë se kanë nevojë të saktësohen më tej. Për pasojë, ndërmarrja e një studimi më të thelluar për kategorinë e foljeve të tipit *erret*, *më teket* etj. në gjuhën shqipe do të ndihmonte në njohjen më të mirë të karakteristikave të këtyre foljeve.

BIBLIOGRAFI

- A. Dozon, *Manuel de la langue chkiye ou albanese*, Paris. 1879.
A. Lacalendola, *Grammatica della lingua albanese*, 1930.
A. Leotti, *Grammatica elementare della lingua albanese* (dialetto tosco). Heidelberg, 1915.
A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe* (pjesa II për klasat e nalta të fillores e të parat e Qytetësës), Shpallje e përmirësuar, Tiranë, 1937.
B. Bauer, *Archaic Syntax in Indo-European: The Spread of Transitivity in Latin and French*, Mouton de Gryter, Berlin-New York, 2000.
D. Camarda, *Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Ristampa anstatica, 1989.
Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002.
Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2005.
Gramatika Latine (Tubë librash për shkollë gymnazike e tregtare botue prej etnve jezuit. Bleni I, Shkodër, 1921.
Gj. Pekmezi, *Albanesisshen Sprache*, Wien, (1908).
I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927,
J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Shkodër, 2006, f. 327.
K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë, 1952.
K. Kristoforidhi, *Gramatiki tis alvanikis glossis*, Kostantinopojë, 1872.

- L. Haegeman, *Introduction to government and binding theory*, second edition, Reprinted, Blackwell, Cambridge, MA, 1992.
- M. Camaj, *Albanian Grammar*, with Exercises, Chrestomachy and Glossaries, Collaborated on and translated by Leonard Fox, Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1984.
- N. Resuli, *Grammatica albanese*, Bologna, 1985.
- O. Myderizi, *Gramatika e Re e shqipes*, Vëllimi I, Fonologji e morfologji, 1944,
- R. D'Angély, *Grammaire albanaise comparée*, L'Énigme, Tome VI-VII..
- R. Memushaj, *Bukuria e gjuhës. Gjuha shqipe 2*, për klasën e dytë të gjimnazit të përgjithshëm, Podgoricë, 2009.
- S. Frashëri, *Shkronjëto e gjuhës shqipe*, Bukuresht, (1886).
- S. Riza, *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, në "Vepra 2", Prishtinë, 1997.
- Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986.